Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

# RAPORT VENDIMMARRJE

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:***Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026.

**Analiza ligjore**: Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Në ligjin Nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republiken e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM Nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".

**Situata aktuale e funksionit:** Kriteret Specifike për vitin 2026 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikëzimit.

1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.

2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me aftësi të kufizuar/invalid pune.

3. Familje me shumë femijë.

4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme, dhe me probleme sociale.

5. Persona qe jetojnë te vetëm të moshuar, që kanë dhe probleme shendetesore.

6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme që ka në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.

7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.

8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.

9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe PAK kane relatuar për projekt vendimin.

Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 28/01/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.02 datë 14/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim mbi miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026."paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

**Albina Livadhi**________________**Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Meliha Zyberaj**________________**Zv.Kryetar i komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Sanije Salja** ________________**Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

## RAPORT VENDIMMARRJE

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë

***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025

**Analiza ligjore**:
Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

**Situata aktuale e funksionit: --**

**Situata financiare** : Projekt vendimi propozon që 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Dhjetor 2025 familje 125, me 404,233 lekë, me 5.98% e fondit total.
2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Dhjetor 2025 janë shpallur fitues, 881 familje, me fond 6,763,811 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 405,828 lekë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe PAK kane relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk eshte objekt i konsultimit publik

Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 28/01/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.01 datë 14/01/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025"paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

**Albina Livadhi**________________**Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Meliha Zyberaj**________________**Zv.Kryetar i komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Sanije Salja** ________________**Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

**Komisoni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit "për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të grantit të bazuar në performancë të Bashkisë Vau Dejës me burim financimi nga financimi i huaj".

**Analiza ligjore:**
Mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit", Ligjin 87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimin Nr 10 datë 12.07.2024 Për "Regjistrimin përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Perfundimtar 20262028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026, sipas shkresës Nr 764 datë 19.12.2025 "Shkresë përcjellëse, mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025" dërguar nga AMVV-ja sipas shkresës Nr 18133/1 datë 24.12.2025 "Detajimi i fondit të Grantit të bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025 me burim financimi nga Buxheti i Shtetit" dërguar nga Ministria e Financave Udhëzimit të Përbashkët Nr 01 date 11.07.2025 "Për kriteret procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025" dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,

**Situata aktuale e funksionit:** Në vendimin e komisionit të Vlersimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025 ne si Bashki jemi vlerësuar sipas kritereve specifike të kërkuara dhe si rezulat sipas nivelit të performancës kemi përfituar një fond prej 4,333,634.43 lekesh me burim financimi nga financimi i huaj. Me anë të këtij projekt vendimi ashtu sic na orienton dhe Ministria e Financave sipas shkresës së përmendur më sipër ne jemi angazhuar ne detajimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi, bazuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr 01 date 11.07.2025 "Për kriteret procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025". Ky fond do të përdoret për zërin e buxhetit"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara+Mbikqyrje+Kolaudim" me kod produkti 1570372, programi 10661, me kapitull 02. Ky projekt është pjesë e projekteve prioritare miratuar me VKB nr 76 datë 23.12.2025 "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve në Bashkinë Vau Dejës me Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkoder nr 884/1 datë 07.01.2026.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit
**Monitorimi dhe raportimi**: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.
**Impakti social / grupet që preken:** Perparesia e ketij projektvendimi eshte permiresimi i sherbimit te ofruar nepermjet planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe i mire-analizuar i shpenzimeve publike me synim rritjen e efektivitetit dhe perdorimit ekonomik te fondeve publike;

Menaxhimi efektiv i te ardhurave totale te bashkise si nje menyre e rendesishme per te rritur investimet dhe ne interesin publik;Rritje e cilesise se infrastruktures ne territorin e bashkise,Konsolidimi i sherbimeve publike,Nxitje e zhvillimit ekonomik per bizneset,Ndërtimi i infrastrukturës parauniversitare,moderne:Infrastruktura rrugore, arsimore.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

**Neki Kapllani**____________________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Arsen Mehmeti**____________________ **Zv.Kryetar i komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Florin Tanushi** ____________________ **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

# RAPORT VENDIMMARRJE

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për pranimin e të moshuarit Z.Lush Kol Kolndrekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

**Analiza ligjore**:
Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republiken e Shqiperisë" i ndryshuar në VKM-në 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për perfituesit e shërbimit të organizuar" Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a): pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfititmit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

**Situata aktuale e funksionit:** Mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social. Bashkia Vau Dejës të Z.Lush Kol Kolndrekaj për sistemimin e tij në qëndren për të moshuar "BESA" Barbullush, është një i moshuar që aktualisht jeton vetem dhe perballet me vështiresi nëe permbushjen e nevojave te perditshme.Z.Lush Kolndrekaj ka 4 vajza te cilat jane te martuara dhe jetojne jashte shtetit, ndersa njera prej tyre jeton ne Tirane. Per shkak te distances gjeografike dhe angazhimeve familjare, vajzat nuk kane mundesi te perkujdesen drejtperdrejte per tea tin. Kjo situate e ka lene te moshuarin pa mbeshtetje te vazhduehme dhe pa ndihmen e duhur per kujdesin ditor, ushqimin dhe trajtimin shendetsor. Ai ka banese ne pronesi por eshte ne kushte shume te pa pershtatshme per banim.Duke marrëparasysh moshen gjendjen shendetsore, vetmine dhe mungesen e kujdesit familjar, prpozohet akomodimi i tij ne Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush", ku do mund te marre perkujdesjen e nevojshme, sherbimet baze te jetetses, ndihmen mjeksore dhe mbeshtetje sociale te vazhdueshme.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**: Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në strehimin e të moshuarit dhe krijimin e kushteve normale pë jetesë pranë Qendres së përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush",

**A është objekt i konsultimit publik:** Nuk eshte objekt i konsultimit publik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 28/01/2026, shqyrtoi projekt vendimin për pranimin e të moshuarit Z.Lush Kol Kolndrekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi ________________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

________________ **Zv.Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

________________ **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë

***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për miratimin e listes së kërkuesve për programin e strehimit social " Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme " ( Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuar).

**Analiza ligjore:** Nenit 24, neni 54 gërma "n" e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015" Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, neni 15 dhe neni 16. VKM nr 384, datë 12.06.2019" Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore; Në procesverbalin e datës 21.01.2026 të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.57 me 27.10.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025, dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 VKB Nr.33 datë 28.04.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit"

**Situata aktuale e funksionit**: Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara).për tu trajtuar me programin "Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme"

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**: Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Komunitetet e varfëra,vurnerabël dhe të pafavorizuara të familjeve të Bashkisë Vau Dejës për programet e strehimit", "Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme".

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

______________________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
______________________ **Zv.Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
______________________ **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

**Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për vazhdimësinë dhe vleren e përfitimit për Z.Ndrec Tanushi dhe Z.Ardjan Lekaj në programin e strehimit "subvencionit të qirasë në tregun e lirë"

**Analiza ligjore**: Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; nenit38 i Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social'i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM-së nr.362 prot, datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 "Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026" në Bashkinë Vau Dejës: VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencion i qirasë në tregun e lirë"; VKB Nr.57.dt.27.10.2025, Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit "VKB-së nr. 47. datë 26.06.2024 "Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatese të banesave". Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 12.12.2025.
**Situata aktuale e funksionit**: Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.57.dt.27.10.2025, Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit ", realizoi mbledhjen në datën 12.12.2025.Ku u be shqyrtimi i dokumentacionit të plotë i rinovuar dhe kontratat e qirasë noteriale për banorët z. Ndrec Tanushi dhe z.Ardjan Lekaj.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**: Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social ka relatuar për projekt vendimin.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

**Impakti social / grupet që preken:** Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.
Komisoni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 28/01/2026, shqyrtoi projekt vendimin për vazhdimësinë dhe vleren e përfitimit për Z.Ndrec Tanushi dhe Z.Ardjan Lekaj në programin e strehimit "subvencionit të qirasë në tregun e lirë"

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

Albana Livadhi ______ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
Melike Zyberaj ______ **Zv.Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
Sonja Sokoli ______ **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

# RAPORT VENDIMMARRJE

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë

***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për miratimin paraprak të planit të mbarështimit në ekonominë pyjore Gjader Mnelë në administrim të Bashkisë Vau Dejës.

**Analiza ligjore**:Mbështetur Ligjin nr 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore"në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 datë 03.04.2020 neni 11 shkronja b dhe c"Për pyjet", manualit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janar 2019 miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nr 864 prot datë 30.01.2019 neni 2, VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive.

**Situata aktuale e funksionit**: Bashkia Vau i Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotava vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31,118 ha Pyje dhe Kullota.Pjesë e këtij administrimi është edhe ekonomia pyjore Gjadër Mnelë, për të cilën është realizuar plani i mbarështimit të Pyjeve dhe kullotave.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Drejtoria menaxhimit te pyjeve,bujqesise dhe mbrojtjes mjedisit.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

**Impakti social / grupet që preken**: Ofrohen aktivitete rekreative dhe turistike dhe për të zhvilluar ekoturizmin midis banorëve. Kjo do të siguroje të ardhura shtesë për ekonominë pyjore dhe në të njëjtën kohë përfaqëson një burim punësimi për popullsinë lokale. Po ashtu edhe aktivitetet ekonomike mund të krijojnë të ardhura të qëndrueshme sidomos në zonat ku sipas përdorimit të territorrit nuk ka mundesi për aktivitetë të tjera.

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.

b) miratimin e projektakteve

**Kastriot Shkjau** ______________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Mirela Vasija** ______________ **Zv.Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë

***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve:

**1.**Për miratimin e listes së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe të pyjeve që kulloten.

**2.**Për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim.

**Analiza ligjore**:Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; neni 9, pika 1.2: neni 27, pika 5; neni 54, shkronja "e/l"; Ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020" Për pyjet", neni 25; Ligjit nr 9693, datë 19.03.2007" Për fondin kullosor publik", të ndryshuar, neni 15, 17 dhe 26; VKM-së nr 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive"i ndryshuar, shtojca 49; Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016" Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari"; Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit e të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

**Situata aktuale e funksionit**: Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilat është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj në lidhje me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara në administrim e saj gjithsej 31,118.2 ha propozojme dhënien e pëlqimit në parim: siperfaqe pyjore 14271.62 ha, sipas listës së ngastrave bashkëngjitur. Fondi kullosor i cili ka kaluar në administrim pranë Bashkisë Vau i Dejës nga inventari i ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, i referohet inventarizimit të fondit kullosor të vitit 1971-1981, i cili përmban hartografinë përkatëse sipas ekonomive kullosore, Pyjore, kapacitetet kullosore si edhe punimet përmirësuese, ndërtimit të veprave ujëmbajtëse në formën e planeve të mbarështimit kullosor. Referuar këtij informacioni është përgatitur edhe lista e kullotave.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Drejtoria menaxhimit te pyjeve,bujqesise dhe mbrojtjes mjedisit.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

**Impakti social / grupet që preken**: Është një mundësi e mirë për përmirësimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit ekonomik të Bashkisë, i cili identifikon mundësitë e reja të zhvillimit ekonomik

potencial. Bazuar në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "për pyjet", neni 25,mund të Zhvillohen aktivitete të ndyshme si punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike etj.

Pas shqyrtimit të projekt vendimeve dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

**1.**T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.

b) miratimin e projektakteve

**Kastriot Shkjau** ______________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
**Mirela Vasija** ______________ **Zv.Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

**Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025, banorë të Bashkisë Vau Dejës.

**Analiza ligjore:** Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,

**Situata aktuale e funksionit:** Objekti i projekt vebndimit është dhënia e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga reshjet e dates 26.10.2025 në territorin e Bashkisë Vau Dejës.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:** Sektori Emergjencave civile.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisioni **i** Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme sektorin e emergjencave civile për zbatimin e projekt vendimit.
**Impakti social / grupet që preken:** Lehtësimi i dëmëve të shkaktuara nga reshjet e dates 26.10.2025 familjeve të prekura.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

| **Kryetar Komisioni** | **Z.V Kryetar komisioni** | **Sekretar Komisioni** |
|---|---|---|
| **Mark Bisha** | **Roberto Trushi** | **Majlinda Ndreca** |

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

**Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.**

## RAPORT VENDIMMARRJE

**Datë 28.01.2026**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë

***Lenda:***Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjes së shtetasit Mark Zef Prendi i dëmtuar nga zjarri me datë 16.12.2025, banor i Bashkisë Vau Dejës.

**Analiza ligjore:**Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar. Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile, neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banasave për vitin 2016" si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,"

**Situata aktuale e funksionit**:Objekti i projekt vendimit është dhënia e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së dëmtuara nga zjarri me datë 16.12.2025, banor i Bashkisë Vau Dejës.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**Sektori Emergjencave civile.

**Monitorimi dhe raportimi**: Komisioni **i** Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme sektorin e emergjencave civile për zbatimin e projekt vendimit.

**Impakti social / grupet që preken:**Lehtësimi i dëmëve të shkaktuara nga zjarri me datë 16.12.2025,familjes së Z.Mark Zef Prendi.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

| **Kryetar Komisioni** | **Z.V Kryetar komisioni** | **Sekretar Komisioni** |
|---|---|---|
| **Mark Bisha** | **Roberto Trushi** | **Majlinda Ndreca** |